

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbimit i pastrimit të territorit administrativ të bashkisë është një detyrë e rëndësishme dhe me efekte të dukshme dhe të prekshme nga qytetarët, ndaj në realizimin e tij sa më të suksesshëm duhet të llogariten shërbimet më kryesore dhe me impakt për banorët.

Në mënyrë që të realizojmë nevojat e territorit me shërbimin e pastrimit, duke patur parasysh specifikat që ka bashkia Sarandë shërbimet janë organizuar dhe llogaritur për dy periudha .

Periudha e parë është ajo që përfshin kryerjen e shërbimit gjatë muajve tetor – maj dhe periudha e dytë qershor - shtator.

Aktivitetet që do të kryhen për realizimin e pastrimit të territorit në bashkinë Sarandë janë :

- Mbledhja, grumbullimi dhe transport mbetjeve urbane për në landfillin e Bajkalit.
- Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve te vëllimshme për ne venddepozitimin e caktuar nga bashkia
- Larje dhe dezinfektim i kazanëve, pusetave dhe hapësirave publike
- Pastrim tregu fruta – perime
- Pastrim tregu i shumicës
- Fshirje me mjet teknologjik e kunetave
- Fshirje me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve gjatë ditës dhe nates
- Larje rrugësh dhe sheshe

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i pastrimit të mbeturinave respekton këto parime të përgjithshme:

- Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit.
- Garantimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës.
- Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peisazhit

## GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE URBANE.

### Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **471** kontenierëve me volum 1.1 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar dhe 50 kontejnereve plastike 0.25 m<sup>3</sup>, 60 kontejner 0.05m<sup>3</sup> si dhe 350 kontejnere metalik 0.25 m<sup>3</sup>. Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, **471** zbrazje kontenierësh/ditë.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate. Te gjithë kontenieret do të sigurohen nga Autoriteti Kontraktor. Mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga Sipërmarrësi.

### Puna që do kryhet:

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane nga pikat e grumbullimit (konteniere metalike dhe kosha betoni) për në landfillin Bajkaj për gjithë territorin e Bashkisë Sarandë. Pastrimi i vendit përreth kontenierëve dhe dizifektimi i tyre. Ky shërbim do të kryhet cdo ditë për periudhën tetor – maj dhe dy shërbime përgjatë periudhës qershor - shtator, gjithsej 487 shërbime.

### Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i transportit të mbeturinave kryhet me mjete që sigurojnë respektimin e kërkesave higjieniko - shëndetësore dhe ekologjike e që respektojnë normat e qarkullimit, duke qenë të pajisura me leje (autorizim) për kalime në rrugë të ndaluara për qarkullimin dhe për qëndrime në vendet e ndalimqarkullimit.

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.
- b. Në çmimin njësi të largimit të mbeturinave urbane përfshihet gjithashtu edhe dezifektimi në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri. Mund të bëhet dezifektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

## Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

1. Autoriteti kontratues do të përcaktojë pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontratues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.

2. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Ky ndryshim bëhet vetëm nga Autoriteti Kontratues. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

- Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
- Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
- Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

3. Meqenese në periudhën qershor – shtator kemi sasine me të madhe të mbetjeve krahasuar me periudhën janar-maj dhe tetor dhjetor,, atehere sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe të transportuara, e përcaktuar në preventivin e pastrimit do të ndahet sipas një grafiku ku në periudhën e pikut do të shtohet shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

4. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

5. Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërmirësimin e tyre.

6. Autoriteti kontratues i kërkon Operatorit të shërbimit, nëse lind nevoja, dhe ky i fundit detyrohet të zbatojë, tërheqë dhe transportimin e mbetjeve urbane nga kontenierët edhe pasi Operatori i shërbimit ka kryer shërbimin e plotë ditor.

### **Rregulla për tu zbatuar**

- a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregulloren “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Gjoha dhe penalitetet”
- b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.
- c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues.
- d. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.
- e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- f. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.
- g. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoha të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- h. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoha për mosplotësim këtij detyrimi.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **5 ( pesë ) copë;**
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 copë**
1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë.**
2. Makine transportuese veteshkarkuese per heqijen e mbetjeve inerte te vellimshme me peshe mbajtese jo me pak se 3 ton **2 (dy ) cope**
3. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) , jo më pak se **1 (një) copë;**
4. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë;**

**Makinat teknologjike duhet te jene ne gjendje te mire teknike dhe te mos kene rrjedhje lengjesh etj.**

#### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Gjithashtu këto mjete duhet të jenë të afta për të garantuar mbrojtjen e mbeturinave nga agjentët atmosferik dhe duhet të jenë subjekt i pasterimeve të përshtatshme periodike. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, duhet të jenë subjekt i bonifikimeve periodike për të parandaluar rreziqe të natyrës shëndetësore e higjienike si dhe të jenë në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh te kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së

kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete sipas Nenit “Sanksionet”

Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.

- a. Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të vendosë dukshëm numrat e pikave mbi njërin nga kontenieret apo ambientet e tjerë rreth pikës sipas “Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre”.
- b. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet „Me ju për një qytet më të pastër“, numri i telefonit të shërbimit 24 orësh të firmës dhe numri i gjelbër i Autoritetit kontratues (808) sipas një formati të miratuar paraprakisht. Gjithashtu në të gjitha makinat dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, orarin kur largohen mbeturinat dhe mesazhe për edukimin ambjental.
- c. Në qoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojnë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet dhe me gjoba në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi.
- d. Subjektet që prodhojnë mbeturina më shumë se ¼ e volumit të një kontenieri, duhet të pajisen me kontenierë personal, brenda territorit të biznesit të vet.
- e. Largimi i mbetjeve të këtyre subjekteve do të kryhet në disa mënyra duke lidhur marrëveshje paraprake me ta:
  - të largohen nga subjekti i kontraktuar nga bashkia duke u diferencuar për tarifën e pastrimit ( sipas sasisë së mbetjeve që prodhon).
  - të largohen nga vetë subjekti për në landfill .
  - të lidh kontratë individuale me subjektin e kontraktuar nga bashkia për largimin e mbetjeve të krijuara.

## LARJE DHE DEZINFEKTIM I KAZANËVE, PUSHTAVE ETJ

### Volumet e punimeve

Operatori i shërbimit do të larë dhe dezinfektojë **471 kontenierë** të volumeve 1.1 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 7 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues. Larja dhe dezinfektimi duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pengoj rritjen e mundëshme bakteriale të kontenieret duke që sjell pasoja të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin, gjithashtu të eliminohet fermentimi i mbetjeve të kontenierët dhe në këtë mënyrë elimini i aromave të pakëndshme të këto kontenier. Të gjitha ujërat e ndotura nga kjo larje dhe dezinfektim, llumi dhe mbeturinat e tjera të mbetura nga ky proces, duhen grumbulluar në kontenier të veçant të zotëruar nga Operatori i shërbimit dhe të eliminohen në përkujdesje me mjedisin.

### Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

### Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.
3. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.
4. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Ky ndryshim bëhet vetëm nga Autoriteti Kontraktues.
5. Autoriteti kontraktues i kërkon Operatorit të shërbimit, nëse lind nevoja, dhe ky i fundit detyrohet të zbatoj, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve edhe pasi Operatori i shërbimit ka kryer shërbimin e plotë ditor.



### Rregulla për tu zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj.
2. Të gjitha lëndët dizifektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit e të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore dhe më pas nga Autoriteti kontratues. Mos miratimi i lëndëve kimike të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

### Mjetet dhe pajisjet

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se **1 (një)copë**.
2. Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese (dezifektues kimik) për dezifektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Dezifektimi dhe deratizimi kryhet me dizifektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë
6. Larja dhe dezifektimi duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pengoj rritjen e mundëshme bakteriale që sjell pasoja të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin, gjithashtu të eliminohet fermentimi i mbetjeve dhe në këtë mënyrë eliminimi i aromave të pakëndshme të këto automjete. Të gjitha ujërat e ndotura nga kjo larje dhe dezifektim, llumi dhe mbeturinat e tjera të mbetura nga ky proces, duhen grumbulluar në kontenier të veçant të zotëruar nga Operatori i shërbimit dhe të eliminohen në përkujdesje me mjedisin.



## MIRËMBAJTJA E PIKAVE GJATË DITËS DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDËRTIMORE DHE TË VËLLIMSHME.

### Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe vendosjen e 471 kontenierëve 1.1m<sup>3</sup>. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

### Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

- a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën e kontraktuar, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (ambalazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për tu depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën e kontraktuar sado larg kontenierit të jetë hedhur, dhe të çfarëdo tipi mbetjeje të jetë.
- b. Ky shërbim kryhet me anë të mjeteve vetëshkarkuese të vogla dhe të hapura që qarkullojnë nëpër të gjitha pikat e grumbullimit të zonës së kontraktuar për të mbledhur dhe larguar çdo papastërti që hidhet dhe depozitohet jashtë kontenierëve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.
- c. Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës së kontratuar do të përdoren kamionçina vetëshkarkuese dhe fadromë.
- d. Mbas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.
- e. Të gjitha mjetet e vogla mund të shkarkohen në autoparkun e operatorit të shërbimit, në njëren prej makinave transportuese me kompaktim për të mënjanuar shkarkimin e këtyre mjeteve direkt në fushën e depozitimit.

Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

- Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
- Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.

- Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.
- f. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- g. Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të pregatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00, me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.
- h. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.
- i. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregulloren “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”.
- j. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë ora e njoftimit apo konstatimit të problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit i shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit të Nenit “Sanksionet”
- k. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.
- l. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- m. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.
- n. Me mbeturina ndërtimore dhe të vëllimshme nënkuptohen të gjitha llojet e mbeturinave të përcaktuara në Nenin “Përkufizimet”

## Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

- Makine transportuese veteshkarkuese për heqjen e mbetjeve inerte të vëllimshme me peshe mbajtëse jo më pak se 3 ton **2 (dy) cope**
- Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
- Automjetet të cilat do të përdoren për këtë shërbim duhet të inspektohen jo më vonë se 6 muaj nga Autoriteti kontratues.
- Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet, lahet dhe dezinfektohet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
- Të gjitha makinat për transportin e mbeturinave ndërtimore dhe të vëllimshme duhet të jenë të regjistruara nga Autoriteti kontratues, të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
- Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t’i paraqitet Autoritetit kontratues para fillimit të veprimtarisë së mësipërme.

Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

## **FSHIRJA E RRUGËVE DHE TROTUAREVE ME KRAHË. ( DITËN DHE NATËN)**

### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, me sipërfaqe sipas preventivit dhe kontratës të cilat do parashikohen në grafikun e punimeve të vendosur nga Autoriteti kontratues.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

- a. Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në: Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar .
- b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.
- c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.
- d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj. Në çdo rrugë duhet të hiqen të gjitha llojet e papastërtive, si psh: letra, qese, etj.
- e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës.
- f. Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.dhe gjatë ditës nga ora 10.00 – 18.00
- b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontratues mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëres palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga sipërmarresja dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.
- d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
  - 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
  - 2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
- e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Autoriteti kontratues i kërkon Operatorit të shërbimit, nëse lind nevoja, dhe ky i fundit detyrohet të zbatoj, fshirjen e disa rrugëve me dorë, edhe pasi Operatori i shërbimit ka kryer shërbimin e plot ditor

#### **Rregulla për tu zbatuar**

- a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo sipërfaqe rruge dhe trotuari në përputhje me Rregulloren “Për Administrimin e Mbeturinave Urbane dhe Pastrimit të Qytetit” dhe në kushtet e kësaj kontrate.
- b. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të penalizohet sipas parashikimit në nenin “Sanksione “
- c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse zonat e gjelbra, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së

shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

- f. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.
- g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.
- h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.
- i. Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj siç është përcaktuar në Nenin ”Përkufizimet”

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

## **FSHIRJE ME MJET TEKNOLOGJIK E RRUGËVE DHE SHESHEVE**

Është menduar të kryhet pastrim me mjete teknologjik i kunetave dhe shesheve në Sarandë, Ksamil, Gjashtë, Metoq, dhe Çukë.

Ky shërbim gjatë verës do të kryhet një herë në dy ditë ( katër muaj qershor – shtator ) dhe në pjesën tjetër të vitit mund të kryhet dy herë në muaj

Rruget qe do kryhet ky sherbim jane sipas listes që do bashkëngjitet.

Fshirja e segmenteve te rrugeve apo shesheve do te kryhet edhe ne situata të tjera me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

### **Mjetet dhe pajisjet për fshirjen speciale të rrugëve**

- a. Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e fshirjes me mjet teknologjik të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.
- b. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes së rrugëve këto mjete:
  - Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4 -6 m<sup>3</sup> te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) d, , jo më pak se **1 (nje) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit.
- c. Automjetet të cilat duhet të përdoren për fshirjen e rrugëve duhet të inspektohen çdo 6 muaj nga Autoriteti kontratues. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të intinerarit ditor.
- d. Të gjitha makinat për fshirjene rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
- e. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
- f. Emri dhe telefoni publik i operatori i shërbimit dhe Autoritetit kontratues, targat dhe shkrimi “Mbani qytetin tuaj të pastër” duhet të jenë të dukshme në automjetet e fshirjes së rrugëve ku shkronjat duhet të jenë të paktën 10 cm.



Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit

## LARJA E RRUGËVE

### Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre, në të cilat do të kryhet shërbimi i larjes speciale periodike të rrugëve për të gjithë zonën e kontraktuar sipas Listës së rrugëve dhe volumeve të tyre për shërbimin e larjes speciale periodike .

Operatori i shërbimit do të kryejë larjen speciale periodike me presion të rrugëve, si shërbim 122 dite ne periudhat e nevojshme në një sipërfaqe prej **199 142** m<sup>2</sup> ( 132 142 m<sup>2</sup> në Sarandë dhe 30000 m<sup>2</sup> në Ksamil) sipas metodologjisë së përcaktuar, në zonën që do të kontraktohet, .

### Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes speciale periodike me makineri teknologjike dhe punëtorë ndihmës, konsiston në:

- Larjen e të gjithë sipërfaqes së rrugës dhe trotuarit duke përdorur tubin anësor për nxjerrjen e ujit me presion dhe bollshëm me një normë harxhimi të ujit gjatë larjes mesatarisht 3 litra/m<sup>2</sup> rrugë dhe punëtorë që pastrojnë me fshesa dhe furçe duke shoqëruar shërbimin e larjes speciale. Qëllimi i këtij shërbimi special periodik është pastrimi total i baltës apo pluhurit që mund të mbetet përgjatë sipërfaqes së rrugës apo trotuarit pas kryerjes së shërbimit të fshirjes me makineri, pra eliminimi total i ndotjes nga pluhuri dhe balta.

### Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja speciale periodike do të bëhet çdo natë, në periudhën e përcaktuar në preventiv ( gjatë verës), gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00- 06.00.
2. Çdo rrugë kryesore dhe dytësore, përcaktuar sipas listës së rrugëve për shërbimin e larjes speciale, do të përfitojë shërbimin e larjes speciale sipas grafikut të këtij shërbimi.

Grafikët e punimeve per realizimin e shërbimeve të larjes speciale të rrugëve dhe trotuareve, përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime

3. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

- a. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
- b. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- c. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

4. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
5. Operatori i Shërbimit duhet të rakordojë sipas grafikut të punimeve, duke përfunduar më parë procesin e plotë të fshirjes për rrugët mbi të cilat do të kryhet larja speciale dhe duke kryer pas përfundimit të këtij shërbimi.
6. Operatori i Shërbimit do të kryejë larjen speciale sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara, bashkëngjitur kësaj kontrate.
7. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### **Rregulla për tu zbatuar**

1. Autoriteti kontratues do të inspektojë gjatë ose pas përfundimit të shërbimit, për të siguruar rigorozisht efektivitetin e këtij shërbimi dhe cilësinë e kërkuar.
2. Do të përdoret ujë me parametra të përcaktuara si më lartë. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes speciale, për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.
3. Përfaqësuesit e Autoritetit kontratues do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe mujore të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes speciale dhe mund t'i kërkojë operatori i shërbimit plotësimin e këtij detyrimi gjatë stinës së verës apo ditëve të tjera të vitit, kur është më e nevojshme, pas një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontratues dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.
4. Do të konsiderohet e pavlefshme kryerja e këtij shërbimi në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontratues për shkaqe të ndryshme.

Autoriteti kontratues do të stimulojë Operatori i shërbimit të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.

5. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larjen speciale, do mbarten nga operatori i shërbimit.
6. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për

larjen speciale të rrugëve.

### **Mjetet dhe pajisje për larjen speciale periodike të rrugëve dhe trotuareve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**;
2. Automjetet të cilat duhet të përdoren për larjen speciale të rrugëve duhet të inspektohen jo më larg se 6 muaj nga Autoriteti kontratues. Çdo makineri për larjen e rrugëve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
3. Të gjitha makinat për larjen speciale të rrugëve duhet të jenë të regjistruara nga Autoriteti kontratues, të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Emri dhe telefoni publik i operatori i shërbimit, targat dhe shkrimi “Me ju për një qytet më të pastër” duhet të jenë të dukshme në automjetet e fshirjes së rrugëve ku shkronjat duhet të jenë të paktën 10 cm.

**“EDUKIMI PUBLIK AMBJENTAL”**

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbeturinave, fshirjes e larjes së rrugëve, gjatë periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet masmediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën dy herë në muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi ndotjen e ambjentit jo vetëm në Shqipëri por edhe në shtetet përreth, shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, si dhe masat që mund të merren për minimizimin e kësaj të fundit. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e qytetit për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë të ambjentaliste.

Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik ambjental që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

Programi i edukimit ambjental që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit ambjental apo plotësimit të pjesshëm të tij aplikohen gjopa sipas Nenit “Sanksionet”